

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

UNMIK/RREG/2005/9
23 shkurt 2005

RREGULORE NR. 2005/9

**PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË NDRYSHUAR TË UNMIK-ut
NR. 2004/2 MBI PENGIMIN E LARJES SË PARAVE DHE VEPRAVE TË
NGJASHME PENALE**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke pasur parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999 të Administratës së Përkohshme të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Duke ditur se pastrimi i parave kërcënon zhvillimin ekonomik, sundimin e së drejtës, sigurinë, stabilitetin dhe kontribuon në krijimin e një klime të përshtatshme për krim të organizuar, korrupcion dhe terrorizëm,

Pas shpalljes së Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2004/2 të datës 5 shkurt 2004 mbi pengimin e larjes së parave dhe veprave të ngjashme penale,

Duke marrë parasysh Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/11 të datës 5 maj 2004 mbi regjistrimin dhe veprimin e partive politike në Kosovë,

Duke përkujtuar se Kodi i përkohshëm penal (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/25 e datës 6 korrik 2003) dhe Kodi i përkohshëm i procedurës penale (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/26 e datës 6 korrik 2003) kanë hyrë në fuqi më 6 prill 2004,

Me qëllim të ndryshimit të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2004/2 për të siguruar përputhshmëri me Kodin e përkohshëm penal, me Kodin e përkohshëm të procedurës penale dhe me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/11 dhe për të vazhduar periudhën për të cilën Rregullorja e ndryshuar e UNMIK-ut nr. 2004/2 mbetet në fuqi,

Me anë të kësaj shpall si vijon:

Neni 1
Ndryshimet

Nga data kur kjo Rregullore hyn në fuqi ndryshohet Rregullorja e ndryshuar e UNMIK-ut nr. 2004/2 si më poshtë:

(a) Neni 1.25 ndryshohet si vijon:

““Veprimtari terroriste” është veprë penale sipas nenit 110 të Kodit të përkohshëm penal të Kosovës dhe”,

(b) Në nenin 2.5(b) fjalët “gjykatës hetues” zëvendësohen me “gjykatës i procedurës paraprake” dhe fjalët “gjykatësi hetues” zëvendësohen me “gjykatësi i procedurës paraprake”,

(c) Në nenin 2.7 fjalët “gjykatës hetues” zëvendësohen me “gjykatës i procedurës paraprake”,

(d) Në nenin 2.8 fjalët “gjykatës hetues” zëvendësohen me “gjykatës i procedurës paraprake” dhe fjalët “gjykatësi hetues” zëvendësohen me “gjykatësi i procedurës paraprake”,

(e) Neni 3.4(c) ndryshohet si vijon:

“Dëshmi për regjistrimin e një partie politike në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/11 të datës 5 maj 2004 për regjistrimin dhe veprimin e partive politike në Kosovë ose”,

(f) Neni 5.3 ndryshohet si vijon:

“Partitë politike mbajnë librat e kontabilitetit ku shënojnë të gjitha të ardhurat sipas burimit, shumës, mënyrës së pagesës, siç është pagesa me para apo me urdhërpagesë dhe të gjitha pagesat sipas marrësit, destinimin e pagesës si dhe mënyrën e pagesës. Librat e kontabilitetit ruhen shtatë vjet dhe janë në dispozicion të Qendrës dhe Zyrës për regjistrimin e partive politike për inspektim me rastin e paraqitjes së kërkesës.”,

(g) Neni 5.5 ndryshohet si vijon:

Raportet gjashtëmujore të dorëzuara në pajtim me nenin 19 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/11 përfshijnë:

(a) Të dhëna për të gjitha kontributet e një burimi për partinë politike të regjistruar nëse vlera e kombinuar e kontributeve të atij burimi i ka tejkaluar 100 € gjatë periudhës që e mbulon raporti i cili tregon:

(i) Vlerën e secilit kontribut të bërë për partinë politike,

(ii) Datën kur është bërë secili kontribut dhe

(iii) Emrin e plotë, adresën dhe numrin e regjistrimit civil, të pasaportës ose të patentëshoferit të UNMIK-ut të kontribuesit dhe

(b) Faturën qëshënon çdo pagesë të bërë për ndonjë person tjetër gjatë periudhës së mbuluar nga raporti, nëse shuma e përgjithshme e të gjitha pagesave për atë person i tejkalon 5.000 € dhe ku theksohet qëllimi i pagesës.”,

(h) Në nenin 5.6 fjalët “raport vjetor” zëvendësohet me “raport financiar gjashtëmujor”;

(i) Fjalja e parë e nenit 5.7 ndryshohet si vijon:

“Zyra për regjistrimin e partive politike mund të shqyrtojë përputhshmërinë e partisë politike me këtë nen dhe mund të pezullojë regjistrimin e partisë politike për shkelje të çdo dispozite të këtij neni në pajtim me nenin 5 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/11. Sanksioni nga ky paragraf është pa pasoja për çfarëdo procedure penale.”,

(j) Në nenin 5.8 fjalët “Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/8 mbi ndryshimin e Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut 2000/16, mbi regjistrimin dhe veprimin e partive politike në Kosovë” zëvendësohen me “Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/11”,

(k) Në nenin 10.2 fjalët “Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/6 të datës 18 mars 2002 mbi masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe të hetimit” zëvendësohen me “Kapitullin XXIX të Kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës”,

(l) Në fjalinë e parë dhe të dytë të nenit 12.2 fjalët “gjykatës hetues” zëvendësohen me “gjykatës i procedurës paraprake”,

(m) Në nenin 15.1(b) fjalët “gjykatës hetues” zëvendësohen me “gjykatës i procedurës paraprake” dhe

(n) Neni 19 ndryshohet si vijon:

“Pos aty ku në nene të caktuara është dhënë shprehimisht një datë e mëvonshme e hyrjes në fuqi, kjo Rregullore hyn në fuqi më 1 mars 2004 dhe mbetet në fuqi deri më 31 gusht 2005. Pas shqyrtimit, kjo periudhë mund të vazhdohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.”

Neni 2
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 1 mars 2005.

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm